



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, par.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2005 merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË STACIONIT TË POMPAVE SHTYTËSE NË FSHATIN BËRRNICË E POSHTME

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit të Stacionit të pompave shtytëse në fshatin Bërrnicë e Poshtme.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 670, të evidencuar në fletën poseduese nr. 159, zona kadastrale Bërrnicë e Poshtme, në sipërfaqe 20 arë,

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 353-84/1 dt.04.02.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri